



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipality of Kaçanik

Drejtoria e Arsimit

04 Nr. 610/01 - 19683 /24

Datë, 16.08.2024

Në bazë të Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Udhëzimit Administrativ nr. 22/2013 për numrin maksimal të nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës, Drejtoria e Arsimit shpallë:

### KONKURS

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë (10) në Gjimnaz dhe Shkollën Profesionale për vitin shkollor 2024/2025

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt  
Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, të gjimnazeve dhe të shkollave profesionale, për vitin shkollor 2024/25, mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç. Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9-të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHTI dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.
2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaz dhe shkollën profesionale, duhet të parqesin këto dokumente:

- Fletëparaqitja (e cila merrret në shkollën në të cilën konkurron)
- Dëftesa origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe
- Certifikata e lindjes.

#### Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për Gjimnaz dhe IAAP për vitin shkollor 2024/2025, bëhet më datën 19, 20 dhe 21 gusht 2024, në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora 08.00-16.00.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën 22.08.2024. Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej 23 gusht 2024. Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë, brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqes ankesë drejtorisë së shkollës, Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe në raste të jashtëzakonshme edhe MAShTI-t, Komisionit për ankesa.

#### A. Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kriteret:

1. Suksesi nga shkollimi i obliguar (40%) 40 pikë
2. Suksesi nga lëndët prioritare në test (20%) 20 pikë
3. Numri i pikëve nga testi (40%) 40 pikë

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë 100 pikë.

4. Kriteri i lëndëve prioritare nga suksesi për gjimnaze është, që mesatarja e këtyre lëndëve të jetë 4 (Së pari llogaritet mesatarja e lëndëve veç e veç, pastaj mesatarja e mesatareve të atyre lëndëve).

5. Kriteri i lëndëve prioritare nga testi për gjimnaze dhe shkolla të mesme është minimumi 40% i pikëve nga ato lëndë.

Shih: Njoftimin e datës 27.06.2024, për kushtet, kriteret dhe afatet e regjistrimit të nxënësve në klasën e X-të, për vitin shkollor 2024-2025.

IAAP "Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka" – Kaçanik

Drejtimi	Profili	Nr.i paral.	Nr.i nxën.
Makineri, prodhim dhe ndërtimtari	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Instalues elektrik</li> </ul>	1	17
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Instalues i ngrohjes, klimatizimit, ujesjellesit</li> </ul>	1	23
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Automekanik</li> </ul>	1	16
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Metalpunues</li> </ul>	1	23
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Trafik rrugor</li> </ul>	1	18
Teknologji e informacionit dhe komunikimit	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Informatikë</li> </ul>	1	22
Ekonomi, administrim dhe juridik	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Administrim zyre dhe menaxhim</li> </ul>	1	26
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontabilist</li> </ul>	1	25
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tregti me pakicë dhe shumicë</li> </ul>	1	32
	<b>Gjithsej</b>	<b>9</b>	<b>202</b>

Gjimnazi "Skënderbeu" - Kaçanik

Nr.	DREJTIMI	Nr. i paraleleve	Nr. i nxënësve
1.	Shkenca Natyrore	1	37
2.	Shkenca Shoqërore-Gjuhësore	1	28
	<b>Gjithsej</b>	<b>2</b>	<b>65</b>

Drejtori i DKAsë  
Z. Zahir Doda

